Pyetësor Kombëtar
para implementimit të programit
“Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë”
(TEYC 2022)

Analizë dhe Raport
2021-2022

© KRK, Shkurt 2022

Pyetësor Kombëtar para implementimit të programit
"Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë" (TEYC 2022),
Analizë dhe Raport, 2021-2022
© 2022 Kongresi Rinor Kombëtar (KRK)
Adresa: Rr. Abdyl Frashëri, Pall. 11, Shkalla 5, Kati 3, Ap. 40
Tiranë, Shqipëri
Email: info@krk.al;
web: https://krk.al//

Autor:
Matilda Karçanaj

Redaktimi dhe komente:
Departamenti i Monitorimit dhe Vlerësimit TEYC22

Përpunimi i të dhënave:
Departamenti i Monitorimit dhe Vlerësimit TEYC22
Matilda Karçanaj

Dizenjimi dhe hartimi i pyetësorit:
Departamenti i Monitorimit dhe Vlerësimit TEYC22
Matilda Karçanaj

Të drejtat e autorit: Ky Pyetësor Kombëtar u realizua nga Kongresi Rinor Kombëtar me mbështetjen e Bashkisë Tiranë (BT) në kuadër të programit "Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë" (TEYC 2022). Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Kongresit Rinor Kombëtar apo të Bashkisë Tiranë. Gjetjet e prezantuara në këtë raport paraqesin vetëm perceptimet e qytetarëve mbi situatën aktuale, nivelet e pjesëmarrjes së të rinjve, njohuritë mbi titullin TEYC 2022 dhe pritshmëritë nga zbatimi i aktiviteteve në kuadër të titullit. Ky studim është pronë e Kongresit Rinor Kombëtar dhe si e tillë të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Kongresin Rinor Kombëtar. Asnjë pjesë e këtij studimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose të përpunohet, shumëfishohet dhe shpërndahet duke përdorur sistemet elektronike, pa lejen me shkrim të Kongresit Rinor Kombëtar, përveç rasteve kur një veprim i tillë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të drejtat e autorit.

Kongresi Rinor Kombëtar (KRK) është një organizatë ombrellë që ka si qëllim mobilizimin e organizatave rinore dhe fuqizimin e rolit të të rinjve në shoqëri. Nëpërmjet Kongresit Rinor Kombëtar të rinjtë në të gjithë Shqipërinë kanë një zë të përbashkët për të adresuar, advokuar dhe lobuar për çështjet që prekin rininë.

Mirënjohje

Për hartimin e këtij raporti mirënjohje e veçantë shkon për Departamentin e Monitorimit dhe Vlerësimit të TEYC 2022, veçanërisht për Menaxheren e M&V, Dikensa Topi, e cila drejtoi procesin e dizenjimit dhe hartimit të pyetësorit, si dhe kontribuoi në pasurimin nga ana përmbajtësore e raportit final me komentet e saj. Gjithashtu, Mariza Rama për kontributin e palodhur në agregimin e të dhënave.

Gjithashtu, lidershipi i TEYC 2022 dha një kontribut të vyer në përgatitjen e raportit final përmes komenteve të tyre, sidomos në drejtim të prioritarizimit të analizës në bazë nënkampionimi. Inputi i tyre u reflektua në draftin final të raportit.

Falenderim shkon për këdo që u realizoi shpërndarjen e pyetësorit, sidomos për kolegët e departamenteve të tjera të TEYC 2022, si ai i Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingut, si dhe Departamenti i Programit.

Përmbajtja

Lista e shkurtimeve 4

Hyrje 5

Metodologjia 6
Pyetësori para implementimit të programit TEYC 2022 6
Kampionimi 6
Mbledhja dhe pastrimi/përpunimi i të dhënave 7
Analiza e të dhënave 7
Kufizime 8

Gjetjet kryesore 9

Të dhëna demografike dhe statistikore 12

Perceptimi i situatës aktuale 15
Problemet kryesore me të cilat po përballet Shqipëria 15
Mundësitë, jetesa aktuale dhe e ardhmja e të rinjve 17
Edukimi jo-formal 19

Pjesëmarrja 22
Niveli i pjesëmarrjes së të anketuarve 22
Njohja me ligjin për rininë dhe të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje 24
(Mos) angazhimi e të rinjve, faktorët 27

Njohuri mbi titullin TEYC 2022 30
Titulli “Kryeqyteti Evropian i Rinisë” 30
Titulli “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë” (TEYC 2022) 30
Thirrja për Projekt-Propozime në kuadër të programit TEYC 2022 33

Pritshmëritë nga zbatimi i programit TEYC 2022 34
Pritshmëritë nga programi TEYC 2022 34
Sygjerime për zbatimin e programit TEYC 2022 37

Konkluzione dhe rekomandime 40

Bibliografia 43

Shtojca

Shtojca 1 - Pyetësori para implementimit të programit TEYC 2022
Shtojca 2 - Perceptimi mbi aktivitetet e zhvilluara në komunitet
Shtojca 3 - Shpërndarja e kampionit në 12 qarqe
Shtojca 4 - Pritshmëritë nga zbatimi i programit TEYC 2022

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
BT	Bashkia Tiranë
CEO	Koordinatori i Përgjithshëm
EYF	European Youth Forum/Forumi Rinor Evropian
KRK	Kongresi Rinor Kombëtar
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
N	Numri
OJF	Organizatë jo-fitimprurëse
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
RCC	Regional Cooperation Council/Këshilli Rajonal për Bashkëpunim
RYCO	Regional Youth Cooperation Office/Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor
TEYC 2022	Tirana European Youth Capital/Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022
TPP	Thirrje për projekt propozime
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

1. Hyrje

Ky raport paraqet analizën e rezultateve të *Pyetësorit para implementimit të programit TEYC 2022*, një pyetësor anonim kombëtar që synoi të mbledhë të dhëna nga publiku para implementimit të programit mbi: perceptimin e situatës aktuale, nivelet e pjesëmarrjes së të rinjve, njohuritë mbi titullin TEYC 2022 si dhe pritshmëritë nga zbatimi i aktiviteteve në kuadër të titullit. Raporti synon të ofrojë të dhëna dhe rekomandime të vlefshme për zbatimin e programit të TEYC 2022.

Përmbajtja e këtij raporti është strukturuar në 9 pjesë kryesore.

Pas seksionit hyrës, shpjegohet metodologjia e përdorur për realizimin e anketimit. Jepen të dhëna të detajuara në lidhje me kampionimin, procesin e mbledhjes dhe pastrimit/përpunimit të të dhënave. Seksioni i metodologjisë paraqet informacion edhe mbi analizën e të dhënave, si dhe kufizimet e raportit.

Pjesa e tretë paraqet në mënyrë të përmbledhur gjetjet kryesore të këtij raporti. Gjetjet kryesore pasohen me seksionin e të dhënave demografike dhe statistikore, në pjesën e katërt.

Vet analiza e pyetësorit është ndarë në tre pjesë kryesore, që qëndrojnë si kapituj më vete. Kështu pra, pjesa e pestë paraqet perceptimin e situatës aktuale duke u ndalur veçanërisht te perceptimi mbi problemet kryesore me të cilat po përballet Shqipëria, si dhe te perceptimi për mundësitë, jetesën aktuale dhe të ardhmen e të rinjve. Paraqet gjithashtu edhe perceptimin për rolin e edukimit jo-formal në zhvillimin personal.

Pjesa e gjashtë trajton nivelin e pjesëmarrjes së të anketuarve. Në këtë aspekt, jep edhe gjetje në lidhje me nivelin e njohjes së ligjit për rininë dhe të drejtat për pjesëmarrje në vendimmarrje, si dhe mbyllet me trajtimin e faktorëve për (mos) angazhimin e të rinjve.

Pjesa e shtatë analizon nivelin e njohurive të anketuarve në lidhje me titullin “Kryeqyteti Evropian i Rinisë”, si dhe “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë” (TEYC 2022). Ndalet veçanërisht te niveli i njohurive që kanë të anketuarit për thirrje për Projekt-Propozime, hapur në kuadër të programit TEYC 2022.

Pjesa e tetë analizon pritshmëritë nga zbatimi i programit TEYC 2022, si dhe merr në konsideratë sygjerimet për zbatimin e programit TEYC 2022.

Ky raport mbyllet me konkluzione dhe rekomandime bazuar në analizën dhe gjetjet e arritura. Ky raport ofron gjithashtu informacion të detajuar për aspekte të caktuara përmes shtojcave që qëndrojnë si pjesë shtesë pas listës së bibliografisë.

2. Metodologjia

2.1 Pyetësori para implementimit të programit TEYC 2022

Pyetësori para implementimit të programit TEYC 2022 është një pyetësor anonim kombëtar që synoi të mbledhë të dhëna të vlefshme para implementimit të programit mbi: perceptimin e situatës aktuale, nivelet e pjesëmarrjes së të rinjve, njohuritë mbi titullin TEYC 2022 si dhe pritshmëritë nga zbatimi i aktiviteteve në kuadër të titullit. Ky pyetësor u përgatit nga Kongresi Rinor Kombëtar në gjuhën shqipe me mbështetjen e një eksperti të jashtëm.

Pyetësori përbëhet nga **62 pyetje në total**, të hapura dhe të mbyllura, nga të cilat:

- 9 janë pyetje demografike dhe statistikore;
- 18 pyetje për perceptimin e situatës aktuale;
- 12 pyetje mbi pjesëmarrjen;
- 5 pyetje rreth njohurive mbi titullin TEYC 2022;
- 17 pyetje rreth pritshmërive nga zbatimi i programit TEYC 2022;
- 1 pyetje e hapur për opinion rreth gjatësisë së pyetësorit dhe qartësisë së pyetjeve.

Pyetësorin e plotë mund ta gjeni në Shtojcën 1.

2.2 Kampionimi

Pavarësisht se titulli i është akorduar Tiranës si Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022, programi synon të shtrihet edhe në bashkitë e tjera, prandaj edhe kampionimi nuk u kufizua vetëm për qytetarët e Tiranës. Për këtë arsye, analiza e mëposhtme mbështetet në një kampionim rastësor prej **557 personash** të grup moshave të ndryshme nga e gjithë Shqipëria, 80% e të cilëve të rinj deri në moshën 30 vjeç.

Pyetësori u shpërnda online përmes e-mail, faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale (Facebook dhe Instagram) të TEYC 2022 dhe Kongresit Rinor Kombëtar, për tu plotësuar në mënyrë anonime, prej 24 Dhjetor 2021 deri më 22 Janar 2022. Pyetësori u shpërnda edhe me partnerët e programit TEYC 2022, si dhe të Kongresit Rinor Kombëtar. Pyetësori u promovua edhe në daljet në media, në rrjetet e nxënësve të shkollave të mesme, në takimet për informimin mbi thirrjen e hapur të TEYC 2022 për të arritur një kampionim sa më të gjerë, si dhe u inkurajua shpërndarja e pyetësorit nga kushdo pa asnjë kufizim.

Kampionimi i këtij pyetësori përfaqëson të 12 qarqet e Shqipërisë, duke përfshirë 32 bashki, si dhe 1.08% e kampionimit kanë deklaruar se janë shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë. Pjesa më e madhe e përgjigjeve kanë ardhur nga Qarku i Tiranës. Pyetësori ka arritur jo vetëm qytetet

dhe zonat e mëdha urbane, por edhe periferitë, zonat e vogla urbane dhe zonat rurale me 33.03%. Gjithashtu, 12.21% e të përgjigjurve raportojnë se e ndjejnë veten pjesë të grupeve të margjinalizuara.

Për të dhëna më të detajuara rreth grupmoshave që kanë plotësuar pyetësorin, referojuni ju lutemi seksionit të analizës së të dhënave demografike mëposhtë.

2.3 Mbledhja dhe pastrimi/përpunimi i të dhënave

Pyetësori është shkruar në një gjuhë të qartë dhe të lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar për të gjithë. Pyetësori u shpërnda në mënyrë online përmes Googleform për tu plotësuar në mënyrë anonime. Procesi i mbledhjes së të dhënave u koordinua nga Departamenti i Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V) të Kongresit Rinor Kombëtar, së bashku me kolegët e departamenteve të tjera si ai i Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingut, si dhe Programit të cilët realizuan shpërndarjen e pyetësorit. Sidoqoftë i gjithë stafi i TEYC 2022 u inkurajua të shpërndajë pyetësorin me informacion shpjegues të dhënë nga departamenti i Marrëdhënive me Publikun dhe Marketingut për shpërndarje dhe arritshmëri sa më të lartë të pyetësorit.

Pyetësori qëndroi i hapur me akses për publikun për 30 ditë. Përgjigjet për pyetësorin janë gjeneruar në mënyrë automatike përmes Googleform. Koha e plotësimit të pyetësorit është regjistruar po ashtu automatikisht.

Pasi u mbyll marrja e përgjigjeve, u bë kontrolli i përgjigjeve nga staf i TEYC 2020, për të verifikuar cilësinë e përgjigjeve të gjeneruara nga Googleform apo për gabime të tjera që mund të gjenerohen automatikisht online. Për këtë arsye të dhënat janë ri-përpunuur përmes formulave në programin Excel për tu siguruar që nuk ka gabime të gjeneruara për shkak të ndonjë gabimi të formatit Googleform.

2.4 Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara u analizuan duke grupuar përgjigjet e të dhënave në kapituj dhe nënkapituj si mëposhtë:

- Informacion demografik dhe statistikor;
- Perceptimi i situatës aktuale;
- Pjesëmarrja e të rinjve;
- Njohuri mbi titullin TEYC 2022;
- Pritshmëritë nga zbatimi i programit TEYC 2022.

Të dhënat e analizuara janë shoqëruar me grafikë për të lehtësuar interpretimin e përgjigjeve.

Të dhënat janë analizuar duke marrë parasysh edhe nën-kampionët e gjinisë, moshës, arsimit apo punësimit dhe vendbanimit. Relevanca e nën-kampionimit është prioritarizuar në varësi të pyetjeve, kur është gjykuar si e nevojshme. Sidoqoftë nëse një njësi specifike e TEYC 2022 apo KRK ka nevojë të përdorë këto të dhëna për qëllimet e programit TEYC 2022, të dhënat bruto mund ti kërkohen departamentit të M&V.

Një pjesë e pyetjeve mbledh të dhëna përmes shkallës së vlerësimit Likert, në 5 pika: (1) nuk jam aspak dakord; (2) nuk jam dakord; (3) as nuk jam dakord, as jam dakord; (4) jam deri diku dakord; (5) jam dakord. Gjetjet jane analizuar duke sjellë sëbashku në *qëndrim pozitiv/pohues* përgjigjet *(4) jam deri diku dakord; (5) jam dakord,* si dhe në qëndrim negativ/mohues përgjigjet për (*1) nuk jam aspak dakord; (2) nuk jam dakord*.

2.5 Kufizime

Duhen pasur parasysh disa kufizime për këtë studim:

- Krijimi i pyetësorit, shpërndarja e tij si dhe analiza e të dhënave është realizuar brenda limiteve kohore shumë të kufizuara, nga mesi i dhjetorit 2021 deri më shkurt 2022, në mënyrë që gjetjet të ndihmojnë në zbatimin e programit TEYC 2022, sidomos në implemtimin e projekteve të mbështetura në kuadër të Thirrjes për Projekt Propozime.
- Për përpunimin dhe analizën e të dhënave të këtij pyetësori ka qenë e pamundur vendosja në dispozicion e një softueri të veçantë prodhuar specifikisht për këtë studim.
- Duke qenë se kampionimi i këtij pyetësori është rastësor, është e vështirë të sigurohet një përfaqësim i barabartë apo i kënaqshëm në nivel nënkampionimi për të gjitha rastet, psh në rastin e përfaqësimit gjinor.
- Shpërndarja e pyetësorit vetëm në formë online, për shkak të kufizimit kohor mund të ketë limituar arritjen e grupeve që nuk kanë akses në internet, por që mund të kenë pasur interes për të ndarë opinionin e tyre.

3. Gjetjet kryesore

- Rreth 80% e personave që kanë plotësuar pyetësorin janë të rinj deri në moshën 30 vjeç.
- Më tepër se dy të tretat e atyre që kanë plotësuar pyetësorin janë femra.
- Rjeti social më i përdorur nga të anketuarit është Instagram.
- Mjeti më i preferuar i komunikimit për të marrë informacion është whats up.

Tre çështjet kryesore që konsiderohen si **probleme kyç** me të cilat po përballet Shqipëria janë:

1. **situata ekonomike** (46.86%),
2. **papunësia rinore** (42.37%) dhe
3. **ikja e trurit** (40.93%).

- 57.45% mendojnë se **Tirana është qytet gjithëpërfshirës** për çdo gjeneratë, përkundrejt 22.62% që nuk e shohin Tiranën si qytet përfshirës.
- 43.81% ndryshe nga 39.14% e tyre pajtohen se **në Shqipëri ka shumë mundësi për të rinjtë që të angazhohen në procese sociale.**
- 47.58% shprehen **të kënaqur me mënyrën si është trajtuar opinioni i tyre kur kanë marrë pjesë në aktivitete rinore më parë,** ndryshe nga 26.39% prej tyre.

64.09% **i japin rëndësi edukimit jo-formal në zhvillimin personal**. Vetëm 9.16% nuk pajtohen se edukimi jo-formal është i rëndësishëm në zhvillimin personal.

- 47.94% **nuk janë dakord se të rinjtë bëjnë një jetë të kënaqshme në Shqipëri**, ndërsa 27.11% mendojnë të kundërtën.
- 75.76% shprehen se **të rinjtë dëshirojnë të largohen nga Shqipëria.** Vetëm 6.10% nuk pajtohen me këtë qëndrim.
- Një **numër i përafërt shprehen se e shohin të ardhmen në Shqipëri** (35.19%; N=196) **me ata që nuk e shohin në Shqipëri** (35.73%; N=199).

Vetëm **rreth 30% ose më pak mendojnë se në vendbanimin e tyre aktual zhvillohen mjaftueshëm aktivitete** të cilat mbështesin inovacionin, iniciativat sipërmarrëse, promovojnë kulturën, diversitetin, politikat për mbrojtjen së mjedisit dhe shëndetit, apo që kanë në fokus rritjen e kapaciteteve të të rinjve, nxitjen e pjesëmarrjes qytetare për të rinjtë, apo që informojnë mbi proceset integruese evropiane dhe mundësitë për programe të BE-së. Pothuajse më tepër se gjysma e të anketuarve nuk pajtohen me këtë qëndrim.

- **19.57% nuk kanë dijeni që ekziston ligji për rininë në Shqipëri**, si dhe 43.63% pavarësisht se e njohin ekzistencën e ligjit **nuk kanë informacion (17.06%) apo kanë nevojë për më tëpër informacion (26.57%**) mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. Ndërsa 36.80% shprehen se janë plotësisht (17.41) ose disi të familiarizuar (19.39%) me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

- 42.37% e të anketuarëve (42.76% e të rinjve) **nuk janë të familiarizuar me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje ose kanë nevojë për më tëpër informacion** dhe 27.47% (29.64% e të rinjve) shprehen se janë disi të familiarziuar. Vetëm 8.44% (5.88% e të rinjve) shprehen se i përdorin këto të drejta për pjesëmarrje, ndërsa 21.72% nuk i përdor pavarësisht se janë të familiarizuar.
- Shumica e atyre që i kanë përdorur këto të drejta u shprehën se kanë përdorur më së shumti të drejtën e tyre **për informim, konsultim, angazhim/pjesëmarrje**.

- 50.80 % **janë aktualisht apo kanë qenë dikur të angazhuar në organizata jo-fitimprurëse (OJF).**

- Ndryshe nga 33.75% e të anketuarve, 66.25% **e konsiderojnë veten aktiv në sferën publike për çështje që shqetësojnë rininë shqiptare** (51.17% deri diku, 15.08% shumë aktiv).

Reth 40-50% identifikuan **tre faktorët me ndikues në mos angazhimin e të rinjve**:

1. Mungesa e besimit se angazhimi i tyre do të ketë ndikim në institucionet publike;
2. Mungesa e besimit në fuqinë e tyre si agjentë ndryshimi dhe
3. Informacion jo i mjaftueshëm mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Rreth 40-49% u shprehën se **rinia shqiptare duhet të jetë më pjesëmarrëse** në qasjen për:

1. mundësitë që rrisin kapacitetin e tyre;
2. hapësirat rinore/komunitare ku zhvillohen potencialet e të rinjve; dhe
3. sipërmarrje/ekonomi kreative.

- 58.17% **kanë dëgjuar më parë për programin "Kryeqyteti Evropian i Rinisë"**.
- Edhe pse 84.74% **kanë dëgjuar për titullin TEYC 2022,** shumica (48.47%) **nuk kishin shumë informacion rreth tij**.
- 58 % **kanë dijeni në lidhje me TPP në kuadër të programit TEYC 2022**.

Fushat më të rëndësishme të veprimtarisë së programit TEYC 2022 shihen:

1. Rinia zhvillon ekonomi kreative dhe inovacion (22.44%);
2. Rinia zhvillon kapacitet (19.39%);
3. Rinia merr pjesë (14.36%);
4. Rinia Evropiane (13.82%);
5. Rinia dhe kultura (11.31%).

Pritshmëritë nga zbatimi i programit TEYC 2022 janë të larta.

73-83% besojnë se zbatimi i programit TEYC 2022 do të:

- rrisë mundësitë e të rinjve për më tepër pjesëmarrje në komunitetin e tyre (81.87%);
- stimulojë të rinjtë për të qenë më proaktiv në çështje që ndikojnë tek ata (82.76%)
- ofrojë mundësi për rritje personale dhe profesionale të të rinjve (80.25%);
- stimulojë të rinjtë në njohjen e fuqisë së tyre si agjentë ndryshimi (78.10%);
- mbështesë sipërmarrjen tek të rinjtë (73.61%);
- nxisë përfshirjen e të rinjve në aktivitete sociale/ kulturore (82.41%)
- rrisë informimin e të rinjve mbi programe të BE-së (79.89%);
- nxisë përfshirjen e të rinjve nga grupet vulnerabël (73.25%);
- krijojë më shumë hapësira kreative për të rinjtë (78.28%);
- rrisë ndërgjegjësimin mbi politikat mjedisore tek të rinjtë (74.69%);
- nxisë nisma për mbrojtjen e shëndetit nga të rinjtë (74.33%);
- rrisë ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e edukimit joformal në zhvillimin personal (79.35%).

4. Të dhëna demografike dhe statistikore

Kjo analizë u mbështet në një kampionim rastësor prej **557 personash**, si e tillë edhe nivelet e nënkampionimit janë rastësore. Kështu që vihet re edhe një reagim i ndryshëm përsa i përket plotësimit të pyetësorit bazuar në gjininë e të anketuarve. **Shumica e të anketuarve janë identifikuar se i përkasin gjinisë femër** (70.38%), ndërsa 27.83% meshkuj. Ndërkohë 1.8% kanë preferuar të mos përgjigjen.



Përsa i përket moshës, **rreth 80% e personave që kanë plotësuar pyetësorin janë të rinj deri në moshën 30 vjeç**. Reagimi më i lartë për këtë pyetësor ka ardhur nga grup mosha e të rinjve 15-18 vjeç (40.39%; N=225), pastaj të rinjtë 19-24 vjeç (24.24%; N=135). Diçka tjetër që vihet re është se reagimi për këtë pyetësor ka ardhur pothuajse në masë të barabartë për grup moshën 15-30 vjeç (14.72%; N=82) dhe 31-40 vjeç (14.54%; N=81). 5.57% e të anketuarve i përkasin moshës mbi 40 vjeç. Ndërkohë pyetësori është plotësuar edhe nga të rinjtë nën moshën 15 vjeç, edhe pse në masë të vogël.

Tabela 1: Grup mosha

Grup mosha	N	%
nën 15 vjeç	3	0.54%
15-18 vjeç	225	40.39%
19-24 vjeç	135	24.24%
25-30 vjeç	82	14.72%
31-40 vjeç	81	14.54%
41-50 vjeç	20	3.59%
Mbi 50 vjeç	11	1.97%

Përsa i përket nivelit të arsimimit, **pjesa më e madhe e të anketuarve kanë deklaruar se niveli i arsimit që kanë përfunduar është Cikli i dytë i studimeve (Master) (30.70%) ose Shkolla e Mesme të Lartë (29.98%)**. Ndërkohë 19.75% kanë përfunduar arsimin bazë dhe 14.90% Ciklin e parë të studimeve (Bachelor). Vetëm 4.49% kanë deklaruar se kanë përfunduar Ciklin e tretë të studimeve.



Përsa i përket nivelit të punësimit të anketuarve, ajo që vihet re është se një numër i konsiderueshëm i tyre (N=232) kanë vetë raportuar se **nuk janë në marrëdhënie punësimi (41.65%)**. Ndërkohë shkalla zyrtare e papunësisë sipas Instat në trermujorin e tretë është 19.9% për moshën 15-29 vjeç dhe 8.7% për moshën 30-64 vjeç, si dhe 11.6% per 15-64 vjeç[1]. Nga rezultatet e këtij pyetësori 97.84% (227 nga 232) e të anketuarve të deklaruar si të papunë i përkasin moshës 15-30 vjeç. 51.36% (227/442) e të rinjve të anketuar prej moshës 15-30 vjeç kanë deklaruar se janë të papunë. Shumica (66.86%) e të rinjve të deklaruar si të papunë i përkasin moshës 15-18 vjeç. Niveli i nënkampionimit të këtij pytësori nuk lejon të nxjerrësh konkluzione pasi na paraqet të dhëna të agregueshme për moshën 15-30 dhe jo 15-29 vjeç.

Ndërkohë 36.45% kanë deklaruar të jenë të punësuar me kohë të plotë apo të vet-punësuar, dhe 9.16% të punësuar me kohë të pjesshme. 10.05% kanë raportuar të jenë nxënës ose studentë. 2.69% kanë raportuar tjetër (si psh vullnetar, shtëpiak, në pension dhe tjetër). Të dhëna më të

[1] INSTAT, "Të dhënat më të fundit: Anketa Tremujore e Forcave të Punës - Shkalla e papunësisë, T3 2017 - T3 2021". Burimi i aksesueshëm (Tabela e Excel) këtu:, http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab2.

detajuara gjenden në tabelën e mëposhtme, përsa i përket statusit të deklaruar të punësimit nga të rinjtë, si dhe për sitautën e përgjithshme të të anketuarve.

Tabela 2: Statusi i punësimit

Statusi i punësimit	N=557	N=442 (15-30 vjeç)	N=217 (19-30 vjeç)
Nxënës/student	10.05%	12.90%	3.23%
Punësuar me kohë të plotë	36.09%	23.30%	46.54%
Punësuar me kohë të pjesshme	9.16%	10.18%	14.29%
I/e papunë	41.65%	51.36%	34.56%
I/e vetëpunësuar	0.36%	0.23%	
Shtëpiak/e	1.62%	1.36%	0.46%
Në pension	0.54%		
Tjetër	0.54%	0.68%	0.92%

Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë deklaruar se jetojnë në qytete apo zona të mëdha urbane) (66.97%). Sidoqoftë, **pyetësori ka arritur edhe periferitë, zonat e vogla urbane dhe zonat rurale me 33.03%**. Specifikisht 25.67% kanë deklaruar se jetojnë në zonë me dendësi popullsie mesatare (qytetet dhe periferitë apo zonat e vogla urbane) dhe 7.36% në zonë me dendësi popullsie të ulët (zona rurale).

Kampionimi i këtij pyetësori përfaqëson të **12 qarqet** e Shqipërisë, duke përfshirë 32 bashki. Pjesa më e madhe e përgjigjeve kanë ardhur nga Qarku i Tiranës (71.99%), duke u pasuar me qarqet e Durrësit (7.90%) dhe të Korçës (7.18%), pastaj qarku i Shkodrës (2.51%) dhe Vlorës (rreth 2%). Ka një numër të barabartë të atyre që kanë plotësuar pyetësorin nga qarku i Lezhës dhe Elbasanit (1.80%), që pasohen pastaj nga qarku i Kukësit, Beratit, Gjirokastrës dhe Fierit. Ajo që vihet re është se pytësori ka arritur edhe të shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë. Në këtë mënyrë 1.08% e kampionimit të këtij pyetësori përbëhet nga shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë. Informacion i detajuar gjendet në Shtojcën 3.

Gjithashtu, **12.21% e të përgjigjurve raportojnë se e ndjejnë veten pjesë të grupeve të margjinalizuara**.

Rjeti social më i përdorur nga të anketuarit është **Instagram** (59.07%) dhe më pak rrjetet e tjera sociale si Facebook (16.43%), Tik Tok (11.31%) dhe Twitter (1.62%). Ndërsa 5.03% përdorin një rrjet tjetër social. Vetëm 6.64% e të anketuarve nuk përdorin rrjete sociale. Përsa i përket mjetit të komunikimit më të preferuar për të marrë informacion, komunikimi përmes whats up është më i preferuar (52.42%), duke u pasuar nga email (27.47%) dhe pastaj Instagram (8.08%). Më pak preferojnë telefonatë (4.31%), sms në telefon (3.23%) apo Facebook (3.05%) apo diçka tjetër (1.26%). Mjeti më pak i preferuar i komunikimit për të marrë informacion është Viber (0.18%).

5. Perceptimi i situatës aktuale

Pyetësori synoi të mbledhë të dhëna rreth perceptimit mbi situatën aktuale në Shqipëri përsa i përket problemeve me të cilat po përballet vendi. Të dhënat e synuara lidhen sidomos me aspekte që shqetësojnë të rinjtë siç janë papunësia, angazhimi i të rinjve në procese sociale, mundësitë e ofruara për aktivizimin e të rinjve, perceptimi mbi jetesën aktuale të të rinjve në Shqipëri si dhe mbi të ardhmen e tyre brenda apo jashtë Shqipërisë. Pyetësori u ndal edhe te perceptimi rreth aktiviteteve që zhvillohen në komunitet për tematika të ndryshme.

5.1 Problemet kryesore me të cilat po përballet Shqipëria

Shqipëria numëroi 661 365 të rinj dhe të reja të grupmoshës 15-29 vjeç përgjatë vitit 2019-2020, duke përfaqësuar kështu një të tretën (23.2%) e të gjithë popullsisë[2]. Gjatë periudhës 2019-2020 emigruan mesatarisht çdo vit rreth 42 000 njerëz jashtë vendit, ndërsa rreth 24 000 njerëz imigruan brenda vendit[3]. Vitet e fundit fenomeni i rrjedhjes së trurit ka qenë një problem shqetësues për shoqërinë shqiptare, sidomos emigrimi i të rinjve. Të dhënat e Eurostat bënë të ditur se në periudhën 2019-2020, rreth 23% e aplikimeve totale për azil ishin nga grup mosha deri në 14 vjeç[4]. Sipas të dhënave të Instat, më 1 janar 2021, mosha medianë e popullsisë rezulton 37.6 vjeç nga 37.2 vjeç që ishte më 1 janar 2020. Ndërkohë, sipas të dhënave më të fundit të të Instat, publikuar në Maj 2021, numri i të rinjve në janar 2021 ishte 643 059 për moshën 15-29 vjeç[5].

Sipas rezultateve të këtij pyetësori, tre çështjet kryesore që konsiderohen si **probleme kyç** me të cilat po përballet Shqipëria janë:

1. situata ekonomike (46.86%),
2. papunësia rinore (42.37%) dhe
3. ikja e trurit (40.93%).

Probleme kyç u konsideruan edhe korrupsioni (38.24%), mungesa e arsimit cilësor (26.57%) dhe problemet me sistemin e drejtësisë (22.80%). Mbi 10% e të anketuarve konsiderojnë si probleme kyç për Shqipërinë problemet me të drejtat e njeriut (13.64%), krimin (12.93%),

[2] Esmeralda Hasani, "Të rinjtë dhe sfidat e integrimit në jetën social, ekonomike e politike", Science and innovation for Development (SCiDEV). Burimi i aksesueshëm këtu: http://debate.scidevcenter.org/te-rinjte-dhe-sfidat-e-integrimit-ne-jeten-social-ekonomike-e-politike/.

[3] INSTAT, "Piramida e Popullsisë së Shqipërisë, Janar 2011-2021". Burimi i aksesueshëm këtu: http://www..instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/piramida-e-popullsis%C3%AB-s%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB/.

[4] Shqip 24, "Statistikat e INSTAT: Ulet numri i studentëve në 2021, të rinjtë shqiptarë me mendjen te të ikurit jashtë vendit", 2021. Burimi i aksesueshëm këtu: https://lajmetshqip24.com/2021/09/07/statistikat-e-instat-ulet-numri-i-studenteve-ne-2021-te-rinjte-shqiptare-me-mendjen-te-te-ikurit-jashte-vendit/.

[5] INSTAT, "Popullsia, Tregues demografikë", Janar 2021. Burimi i aksesueshëm këtu: http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2.

mosëmarrëveshjet politike (10.41%), problemet mjedisore përfshirë edhe efektet e ndryshimeve klimatike (10.23%).

Studime të tjera të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)[6] dhe Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC)[7] raportojnë gjetje të ngjashme për shqetësimet e të rinjve që përfshijnë ndër të tjera edhe korrupsionin, specifikisht krimi i organizuar dhe krimi i urrejtjes. Një gjetje e rëndësishme në rastin e Shqipërisë është se sipas studimit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor dhe Kombeve të Bashkuara "Shared Futures", të rinjtë në Shqipëri shprehen ndër më të pakënaqurit me sistemin arsimor, pas Maqedonisë së Veriut. Të pyetur sa sa të kënaqur janë me sistemin arsimor në një shifër 1-5, ku 1 nënkupton plotësisht të pakënaqur dhe 5 është plotësisht i kënaqur, të rinjtë në Shqipëri e vlerësojnë sistemin arsimor në 2.8[8]. Edhe në rastin e mundësive të punësimit, të rinjtë shqiptarë u shprehën ndër më të pakënaqurit në rajon, pas Kosovës. Kështu mesatarja e vlerësimit për mundësitë e punësimit u vlerësua në rastin e Shqipërisë me 2.01 nga femrat dhe 2.19 nga meshkujt.



[6] UNDP/RYCO, Studimi "Shared Futures: Youth Perceptions on Peace in the Western Balkans", 2021. Burimi i aksesueshëm këtu: https://shared-futures.com/wp-content/uploads/2021/06/Shared-Futures-Youth-Perceptions-on-Peace-in-the-Western-Balkans.pdf.

[7] RCC, "Balkan Barometer 2020, Opinioni Publik, Raport Analitik". Burimi i aksesueshëm këtu: https://www.rcc.int/download/docs/2020-06-Balkan-Barometer-Public-Opinion_final.pdf/bf27f9fc10de8a02df9db2b60596f0cd.pdf dhe "Balkan Barometer 2021, version i shkurtër", i aksesueshëm këtu: https://www.rcc.int/download/docs/Balkan_Barometer_pocket_web.pdf/d885791a77366a17791270b95a162c16.pdf.

[8] UNDP/RYCO, Studimi "Shared Futures: Youth Perceptions on Peace in the Western Balkans", 2021, fq 40. Burimi i aksesueshëm këtu: https://shared-futures.com/wp-content/uploads/2021/06/Shared-Futures-Youth-Perceptions-on-Peace-in-the-Western-Balkans.pdf.

5.2 Mundësitë, jetesa aktuale dhe e ardhmja e të rinjve

Pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen pozitivisht për Tiranën si **qytet përfshirës për çdo gjeneratë.** Konkretisht 57.45% e të anketuarve mendojnë se Tirana është qytet gjithëpërfshirës, përkundrejt 22.62% që nuk e shohin Tiranën si qytet përfshirës.

Gjithashtu, 43.81% e të anketuarve ndryshe nga 39.14% e tyre pajtohen se **në Shqipëri ka shumë mundësi për të rinjtë që të angazhohen në procese sociale.** Po ashtu, 47.58% shprehen se janë **të kënaqur me mënyrën si është trajtuar opinioni i tyre kur kanë marrë pjesë në aktivitete rinore më parë**, në kundërshtim me 26.39% prej tyre.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të anketuarve (47.94%) **nuk janë dakord se të rinjtë bëjnë një jetë të kënaqshme në Shqipëri**. Vetëm 27.11% mendojnë të kundërtën. Shumica e të anketuarve (75.76%) shprehen se **të rinjtë dëshirojnë të largohen nga Shqipëria**. Vetëm 6.10% nuk pajtohen me këtë qëndrim.

Një **numër pothuajse i barabartë i të anketuarve shprehen se e shohin të ardhmen në Shqipëri (35.19%; N=196) me ata që nuk e shohin të ardhmen në Shqipëri** (35.73%; N=199). Po ashtu 19.03% nuk janë të sigurt dhe 10.05% nuk japin dot qëndrim në këtë aspekt. Informacion i detajuar gjendet në tabelën 3.

Sipas studimit "Shared Futures" mesatarisht 52% e të rinjve në rajonin e Ballkanit shprehen se e shohin veten e tyre duke jetuar jashtë vendit në 10 vite[9]. Ndërkohë sipas Barometrit të Ballkanit, në 2015 rrjedhje trurit/emigrimi nuk ishte një shqetësim për opinion publik, ndërsa në 2021 është një ndër shqëtësimet kryesore[10].

Tabela 3 - Perceptimi i situatës aktuale

Ju lutemi jepni opinionin tuaj ndaj pohimeve të mëposhtme	Shkallë vlerësimi 1-5	**557**	100%		
Tirana është një qytet përfshirës (inclusive) për çdo gjeneratë	nuk jam aspak dakord	55	9.87%	Jo dakord	22.62%
	nuk jam dakord	71	12.75%	Jo dakord	
	as nuk jam dakord, as jam dakord	98	17.59%		
	jam deri diku dakord	202	36.27%	Dakord	
	jam plotesisht dakord	118	21.18%	Dakord	57.45%
	nuk jap dot qendrim	13	2.33%		

[9] UNDP/RYCO, Studimi "Shared Futures: Youth Perceptions on Peace in the Western Balkans", 2021, fq 14. Burimi i aksesueshëm këtu: https://shared-futures.com/wp-content/uploads/2021/06/Shared-Futures-Youth-Perceptions-on-Peace-in-the-Western-Balkans.pdf.

[10] RCC, Balkan Barometer 2021, version i shkurtër", fq.5. Burimi i aksesueshëm këtu: https://www.rcc.int/download/docs/Balkan_Barometer_pocket_web.pdf/d885791a77366a17791270b95a162c16.pdf.

Në Shqipëri ka shumë mundësi për të rinjtë që të angazhohen në procese sociale	nuk jam aspak dakord	87	15.62%	Jo dakord	39.14%
	nuk jam dakord	131	23.52%	Jo dakord	
	as nuk jam dakord, as jam dakord	89	15.98%		
	jam deri diku dakord	180	32.32%	Dakord	
	jam plotesisht dakord	64	11.49%	Dakord	43.81%
	nuk jap dot qendrim	6	1.08%		
Jam i/e kënaqur me mënyrën si është trajtuar opinioni im kur kam marrë pjesë në aktivitete rinore më parë	nuk jam aspak dakord	69	12.39%	Jo dakord	26.39%
	nuk jam dakord	78	14.00%	Jo dakord	
	as nuk jam dakord, as jam dakord	95	17.06%		
	jam deri diku dakord	176	31.60%	Dakord	
	jam plotesisht dakord	89	15.98%	Dakord	47.58%
	nuk jap dot qendrim	50	8.98%		
Në Shqipëri të rinjtë bëjnë relativisht një jetë të kënaqshme	nuk jam aspak dakord	117	21.01%	Jo dakord	47.94%
	nuk jam dakord	150	26.93%	Jo dakord	
	as nuk jam dakord, as jam dakord	126	22.62%		
	jam deri diku dakord	119	21.36%	Dakord	
	jam plotesisht dakord	32	5.75%	Dakord	27.11%
	nuk jap dot qendrim	13	2.33%		
Të rinjtë dëshirojnë të largohen nga Shqipëria	nuk jam aspak dakord	15	2.69%	Jo dakord	6.10%
	nuk jam dakord	19	3.41%	Jo dakord	
	as nuk jam dakord, as jam dakord	37	6.64%		
	jam deri diku dakord	143	25.67%	Dakord	
	jam plotesisht dakord	279	50.09%	Dakord	75.76%
	nuk jap dot qendrim	64	11.49%		
Të ardhmen time e shoh në Shqipëri	nuk jam aspak dakord	120	21.54%	Jo dakord	35.73%
	nuk jam dakord	79	14.18%	Jo dakord	
	as nuk jam dakord, as jam dakord	106	19.03%		
	jam deri diku dakord	102	18.31%	Dakord	

	jam plotesisht dakord	94	16.88%	Dakord	35.19%
	nuk jap dot qendrim	56	10.05%		

5.3 Edukimi jo-formal

Përveç edukimit formal të fituar në institucionet zyrtare arsimore (shkolla apo universitet, etj), një rol të rëndësishëm te të nxënit e zë edhe edukimi joformal përmes aktiviteve të ndryshme si kurse te shkurtra, trajnime, shërbim vullnetar lokal apo evropian, angazhimi në projekte te ndryshme, etj.

Edukimi jo-formal është një qasje themelore për ndërtimin e besimit midis individëve dhe njerëzit fillojnë t'i besojnë instinkteve të tyre duke mësuar metoda të ndryshme në çdo fushë[11]. Ndër të tjera ofron një platformë për zhvillimin e aftësive të reja dhe gjeneron mundësi për njerëzit që janë përtej mundësive të arsimit tradicional[12]. Pjesa më e madhe e të anketuarve **(64.09%) i japin rëndësi edukimit jo-formal në zhvillimin personal**. Më tepër detaje gjenden në grafikun e mëposhtëm.



Sipas ligjit për rininë "Edukimi joformal për të rinjtë" është çdo veprimtari e organizuar dhe e përshtatur për të rinjtë, jashtë sistemit formal të arsimit, i bazuar në nevojat dhe interesat e të rinjve, parimet e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset e të nxënit,

[11] GETMYUNI, "Non-formal Education - Guide to a Holistic Growth", 2022. Burimi i aksesuseshëm këtu: https://www.getmyuni.com/articles/non-formal-education.
[12] Po aty.

nëpërmjet të cilit fitojnë kompetenca të nevojshme për zhvillimin e potencialit personal, pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe aksesit në tregun e punës[13]. Prandaj është e rëndësishme të inkurajohet pjesëmarrja sidomos e të rinjve në aktivitete të tilla. Në këtë aspekt, është e nevojshme të mbështeten iniciativa të edukimit jo-formal sidomos përmes Thirrjeve për Projekt-Propozime që kanë në fokus rininë, të hapura për shoqërinë civile, grupet informale apo individë. Për këtë arsye, programi TEYC 2022 synon përmes TPP[14] nxitjen e pjesëmarrjes qytetare për të rinjtë përmes mundësive të ndryshme për tu angazhuar.

Nga rezultatet e këtij pyetësori, vihet re sërish nevoja për të investuar me projekte që do të zhvillojnë aktivitete që synojnë të mbështesin inovacionin, iniciativat sipërmarrëse, rritjen e kapaciteteve të të rinjve, promovimin e diversitetit, politikave për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit, si dhe ti informojnë të rinjtë mbi proceset integruese evropiane dhe mundësitë për programe të BE-së. Mbi 50% e të anketuarve u shprehën se në vendbanimin e tyre nuk zhvillohen mjaftueshëm aktivitete që trajtojnë çështjet e sapopërmendura.

Vetëm **rreth 30% e të anketuarve ose më pak mendojnë se në vendbanimin e tyre aktual zhvillohen mjaftueshëm aktivitete** të cilat:

- mbështesin inovacionin (21.36%);
- mbështesin iniciativat sipërmarrëse (trajnimë për sipërmarrjen, mbështetje për startupet) (20.65%);
- promovojnë kulturën (30.88%);
- kanë në fokus rritjen e kapaciteteve të të rinjve (27.47%);
- kanë në fokus nxitjen e pjesëmarrjes qytetare për të rinjtë (29.98%);
- promovojnë apo/dhe mbrojnë diversitetin (22.44%);
- informojnë mbi proceset integruese evropiane dhe mundësitë për programe të BE-së (20.83%);
- kanë në fokus promovimin politikave për mbrojtjen së mjedisit (25.31%);
- kanë në fokus promovimin politikave për mbrojtjen e shëndetit (25.49%).

Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë që nuk zhvillohen mjaftueshëm aktivitete në fushat e sipërpërmendura (48%-59%). Po ashtu vetëm 28.55% e të anketuarve shprehen pozitivisht se ka hapësira rekreative/rinore/komunitaire për tu përdorur nga të rinjtë.

[13] Ligji Nr. 75/2019, "Për Rininë", Republika e Shqipërisë. Një përmbledhje të ligjit mund ta gjeni të aksesueshme këtu: https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf.
[14] TEYC 2022, Faqja zyrtare e programit e aksesueshme këtu: https://tiranaeyc2022.al/.

Informacion i detajuar gjendet në Shtojcën 2.

6. Pjesëmarrja

Ekzistojnë nivele të ndryshme të pjesëmarrjes, duke filluar nga ai me pjesëmarrje më të ulët deri te niveli me pjesëmarrje më të lartë: informimi, konsultimi, angazhimi, bashkëpunimi dhe fuqizimi[15].

Sidoqoftë angazhimi domethënës i të rinjve mbetet sfidues. Roli i të rinjve në shoqëri dhe në procese kyçe si një forcë pozitive, sidomos në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme, ka fituar vrull të rëndësishëm që nga miratimi i rezolutës 2250 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi rininë, paqen dhe sigurinë (YPS) më 9 dhjetor 2015[16].

Studime të ndryshme sjellin në vëmendje potencialin e të rinjve për angazhim. Kështu, psh studimi i Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), më 2021, tregon një nivel të ulët të angazhimit të të rinjve (19.5%) në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Nga ana tjetër, mbi 65% e të rinjve të rajonit raportojnë interes për tu përfshirë në mënyrë më aktive, duke na treguar kështu potencialin e të rinjve dhe nevojës për t'i krijuar hapësirë angazhimi për të rritur kapacitetet e tyre por edhe për të kontribuar në shoqëri për çështje që shqetësojnë sidomos rininë. Sipas gjetjeve të këtij studimi hapësira qytetare është themeli i çdo shoqërie të hapur, kohezive dhe demokratike, si dhe hapja e rrugës për rritjen e angazhimit dhe ndjenjës së lirisë së të rinjve konsiderohet si kritike[17].

6.1 Niveli i pjesëmarrjes së të anketuarve

Bazuar në rezultatet e këtij pyetësori, 50.80 % e të anketuarve u shprehën se **janë aktualisht (33.03%) apo kanë qenë dikur (17.77%) të angazhuar në organizata jo-fitimprurese (OJF)**. Nga këto 30.39% u shprehën se organizata ku ishin aktualisht apo ku kishin qenë më parë të angazhuar është pjesë e KRK dhe 36.39% nuk kishin dijeni në lidhje me këtë gjë. Nga ana tjetër, 33.22% e të angazhuarëve aktual apo të dikurshëm në OJF, u shprehën se organizata e tyre nuk ishte pjesë e KRK.

[15] Ilona Lodewijckx, "The ladder of citizen participation and community engagement", 2021, Citizen lab. Burimi i aksesueshëm këtu: https://www.citizenlab.co/blog/civic-engagement/ladder-citizen-participation/.
[16] Global Campaign for Peace Education, "Rinia, paqja dhe siguria - Një manual programimi", 2021. Burimi i aksesueshëm këtu: https://www.peace-ed-campaign.org/sq/youth-peace-and-security-a-programming-handbook/ dhe Youth4peace, "About the Youth, Peace & Security Agenda". Burimi i aksesueshëm këtu: https://www.youth4peace.info/About_YPS_Agenda
[17] UNDP/RYCO, Studimi "Shared Futures: Youth Perceptions on Peace in the Western Balkans", 2021, fq 13. Burimi i aksesueshëm këtu: https://shared-futures.com/wp-content/uploads/2021/06/Shared-Futures-Youth-Perceptions-on-Peace-in-the-Western-Balkans.pdf.

Në masë pothuajse të barabartë ishin përgjigjet e atyre që deklaruan se nuk kanë qenë ndonjëherë të angazhuar në një OJF por janë aktiv në sferën publike (24.60%; N=137) më ata që nuk kanë qenë të angazhuar dhe që as nuk e konsiderojnë veten të angazhuar në sferën publike (24.42%; N=136). Informacion më i detajuar gjendet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4: Angazhimi në OJF dhe në sferën publike

A jeni i angazhuar në një organizatë jo fitimprurëse (OJF)?	#	%
Po, aktualisht jam i angazhuar në OJF	184	33.03%
Po, kam qenë i angazhuar por nuk jam aktualisht	99	17.77%
Jo nuk kam qenë angazhuar ndonjëherë në një OJF por jam aktiv në sferën publike	137	24.60%
Jo nuk kam qënë i angazhuar dhe nuk e konsideroj veten aktiv në sferën publike	136	24.42%
Preferoj të mos përgjigjem	1	0.18%

Të anketuarit u pyetën edhe në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në aktivitete/veprimtari jashtëshkollore si dhe për kohën e kaluar ne aktivitete sociale dhe kulturore.

75.22% shprehen se kanë marrë pjesë në aktivitete/veprimtari rinore jashtëshkollore, ndërsa 10.05% shprehen se nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet/veprimtari rinore jashtëshkollore. Shumica e atyre qe u shprehën se kanë marrë pjesë në aktivitete/veprimtari jashtëshkollore janë të rinjtë deri në moshën 30 vjeç (84.65%).

79.89% e të anketuarve u shprehën se **ndjekin aktivitete sociale/kulturore**, përkundrejt 20.11% të cilët u shprehën se kalojnë 0 orë në aktivitete sociale/kulturore. Nga këta 89.29% i përkasin moshës 15-30 vjeç. Shumica deklaruan se kalojnë 1-4 orë në aktivitete sociale/kulturore. Në tabelën e vijuese do të gjeni informacion specifik rreth sa orë kalojnë afërsisht në aktivitete sociale/kulturore.

Tabela 5: Koha e kaluar në aktivitete sociale/kulturore

Sa orë në javë afërsisht kaloni në aktivitete sociale/kulturore?	#	%
0	112	20.11%
1-4	246	44.17%
5-10	113	20.29%
11-14	28	5.03%
15-20	27	4.85%
21-24	15	2.69%
25-30	7	1.26%
Mbi 30 orë	9	1.62%

6.2 Njohja me ligjin për rininë dhe të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje

Objekti i ligjit për rininë është mbrojtja e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimi i kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimi i funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimi me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë[18]. Sipas Nenit 2, qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i veprimtarive, mekanizmave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, si dhe financimin e veprimtarive rinore, në kuadër të së drejtës së të rinjve për mbrojtje të veçantë nga shteti[19].

Shumica e të anketuarve deklarojnë se janë në dijeni të ligjit për rininë, por jo të gjithë shprehen se janë plotësisht të familiarizuar me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. Kështu pra, **43.63% e të anketuarve shprehen se janë në dijeni të ligjit për rininë por nuk kanë informacion (17.06%) ose kanë nevojë për më tepër informacion (26.57%)** mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. **19.57% nuk kanë dijeni që ekziston ligji për rininë në Shqipëri**, ndërsa 36.80% shprehen se janë plotësisht (17.41%) ose disi të familiarizuar (19.39%) me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.



Në këto kushte kur ata që shprehen se nuk kanë dijeni që ekziston ligji për rininë në Shëqipëri (19.57%), ose pavërësisht se e njohin ekzistencën e ligjit nuk kanë dijeni (17.06%) apo duan me tëpër informacion (26.57%) mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, përbëjnë

[18] Ligji Nr. 75/2019, "Për Rininë". Republika e Shqipërisë, Neni 1. Faqja 1. Ligji i plotë i aksesueshëm këtu: https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20191107152923ligj%20nr.%2075,%20dt.%204.11.2019.pdf.
[19] Po aty. Neni 2. Faqja 1.

pjesën më e madhe e të anketuarve, rekomandohet realizimi i sesionet informuese në terren, pasi ky ligj synon të garantojë mbrojtjen e të drejatve të të rinjve. Mungesa e informacionit për të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga ligji për rininë pengon adresimin e dhunimit të të drejtave të të rinjve.

Po ashtu vihet re se 42.37% e të anketuarëve (42.76% e të rinjve) deklarojnë se **nuk janë të familiarizuar me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje ose kanë nevojë për më tëpër informacion** dhe 27.47% (29.64% e të rinjve) shprehen se janë disi të familiarziuar. Vetëm 8.44% e të anketuarve (5.88% e të rinjve) shprehen se i përdorin këto të drejta për pjesëmarrje, ndërsa 21.72% nuk i përdor pavarësisht se janë të familiarizuar me to.

Në një situatë të tillë është e nevojshme informimi i të rinjve sidomos edhe rreth parimeve për mbështetjen e veprimtarisë së të rinjve. Sipas ligjit për rininë, mbështetja dhe fuqizimi i të rinjve bazohet në parimet e mëposhtme[20]:

1. parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit;
2. parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integrimit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve;
3. parimin e lirisë së organizimit të iniciativave rinore dhe të vetëqeverisjes së organizatave;
4. parimin e subsidiaritetit.



[20] Ligji Nr. 75/2019, "Për Rininë". Republika e Shqipërisë, fq 2 dhe 3. Ligji i plotë i aksesueshëm këtu: https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20191107152923ligj%20nr.%2075,%20dt.%204.11.2019.pdf.

Shumica e atyre që i kanë përdorur këto të drejta (mbi 90% e tyre) u shprehën përmes përgjigjeve për një pyetje të hapur se kanë përdorur më së shumti të drejtën e tyre **për informim, konsultim, angazhim/pjesëmarrje**, kryesisht pranë institucioneve të bashkive dhe shkollave.

Në bashki i kanë përdorur të drejtat e tyre kryesisht: për të dëgjuar, diskutuar apo pjesëmarrje në miratimin e buxhetit, sidomos për buxhetin e rinisë; kërkesë për informacion lidhur me vendime të ndryshme për zonën ku banojnë; lobim për krijimin e komisioneve rinore në bashki.

Në shkollë i kanë përdorur këto të drejta për informim dhe pjesëmarrje në aktivitete në lidhje me kulturën dhe rininë organizuar nga shkolla. Gjithashtu, duke kontribuar në garantimin e të drejtës për informim të të rinjve, në garantimin e të drejtës për të qenë pjesë e strukturave vendimmarrëse brenda shkollës, në veprimtari që kanë në themel vullnetarizmin, etj. Një formë tjetër ishte përmes mësimëdhënies në shkollë dhe rekomandimeve për përmirësimin e kurrikulave shkollore, trajtimi i drejtë dhe edukimi i barazisë gjinore brenda ligjeve dhe kurrikulave shkollore.

Një aspekt shumë i rëndësishëm që u përmend ishte edhe për shkollimin profesional të të rinjve me aftësi të kufizuar dhe punësimin e tyre.

Të anketuarit ishin angazhuar edhe në dëgjesa publike për planifikimin e territorit. Një institucion tjetër ku i kishin përdorur të drejtat e tyre ishte edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Gjithashtu të anketuarit kishin paraqitur disa herë kërkesa me protokoll per informacion ndaj institucioneve.

Të drejtat i kishin ushtruar edhe **përmes votës** në zgjedhjet elektorale apo për angazhimi në sektorin publik dhe bashkëqeverisje rinore.

Një aspekt tjetër ku i kishin përdorur këto të drejta ishte në **shkrim, aplikim dhe zbatim projektesh**, kryesisht projektesh rinore. Në këtë linjë u përmendën dhe pjesëmarrja aktive në programe që lidhen me rininë si trajnime të ndryshme apo kampe verore.

Një formë tjetër e ushtimit të këtyre të drejtave ishte përmes **peticioneve dhe plotësimit të pyetësorëve** si në rastin e këtij pyetësori.

Rastet e tjera që u përmendën ishin për raportimin e rasteve e dhunës në familje ku janë përfshirë edhe të mitur; reagimi në rastet e mohimit të drejtës së arsimimit të një bashkëmoshatarje, si dhe në rastet e mohimit të fjalës.

Sidoqoftë, pati edhe nga ata të anketuar që u shprehën se *pjesëmarrja në vendimmarrje* ju dukej *fiktive* dhe *konsultimet* ju jepnin përshtypjen sikur *bëhen sa për të thënë*. Ky perceptim është gjithashtu një faktor që demotivon angazhimin e të rinjve në përgjithësi, çështje që do të trajtohet në seksionin në vijim.

6.3 (Mos) angazhimi e të rinjve, faktorët

66.25% e të anketuarve u shprehën se **e konsiderojnë veten aktiv në sferën publike për çështje që shqetësojnë rininë shqiptare**. 77.78% e këtij grupi i përkët të grupmoshës 15-30 vjeç. Në total 64.93% e të gjithë të rinjve prej moshës 15-30 vjeç të këtij kampionimi kanë deklaruar se konsiderojnë veten aktiv në sferën publike për çështje që shqetësojnë rininë shqiptare.

Nga ana tjetër vetëm 32.14% mendojnë se rinia shqiptare është e angazhuar mjaftueshëm në çështje që shqetësojnë rininë dhe ka rezultatet. Ndërsa 55.48% mendojnë se rinia nuk është e angazhuar mjaftueshëm për çështjet e tyre. 12.39% mendojnë se nuk është e angazhuar fare.



Reth 40-50% e të anketuarve identfikuan **tre faktorët me ndikues në mos angazhimin e të rinjve** arsyet e mëposhtme:

1. Nuk kanë besim se angazhimi i tyre do të ketë ndikim në institucionet publike (50.63%).

Në këtë aspekt është e nevojshme që të krijohen hapësira për një përfshirje më cilësore e të rinjve ku garantohet marrja në konsideratë e përfshirjes së tyre.

2. Nuk kanë besim në fuqinë e tyre si agjentë ndryshimi (40.04%).

Vihet re për një edukim dhe ndërgjegjësim të të rinjve në rolin e tyre si agjentë ndryshimi në Shqipëri. Më pas do të vëmë re që shumica e të anketuarve e shohin këtë si pritshmëri nga programi. Pikërisht, 78.10% e të anketuarve besojnë se zbatimi i programit TEYC 2022 do të stimulojë të rinjtë në njohjen e fuqisë së tyre si agjentë ndryshimi.

3. Të rinjtë nuk kanë informacion mjaftueshëm mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre (39.5%).

Ashtu sikurse u përmend edhe më lart 42.37% e të anketuarve deklaruan se nuk janë të familiarizuar me të drejtat e të rinjve për pjesëmarrje në vendimmarrje ose kanë nevojë për më tepër informacion. Bazuar në këtë nivel përgjigjshmërie, shihet e nevojshme të adresohet kjo çështje me qëllim informimin e të rinjve për të drejtat e tyre. Seksionet e informimit me të rinjtë, qoftë në institucionet arsimore apo përmes angazhimit të shoqërisë civile, qeverisjes lokale e të tjera, mund të ishin me vlerë.



Rreth **40-49%** e të anketuarve u shprehën se **rinia shqiptare duhet të jetë më pjesëmarrëse** në tre fushat kryesore të mëposhtme në qasjen për:

1. mundësitë që rrisin kapacitetin e tyre;
2. hapsirat rinore/komunitare ku zhvillohen potencialet e të rinjve;
3. sipërmarrje/ekonomi kreative.

Rreth **25%-35%** u shprehën se fushat e tjera ku të rinjtë duhet të angazhohen më tepër ishin në qasjen ndaj:

- inovacionit;

- pjesëmarrjes qytetare në përgjithësi;
- njohjes së proceseve integruese/evropiane;
- promovimit të kulturës.

Krahasuar me alternativat e tjera, **më pak se 20%** mendonin se të rinjtë duhet të jenë më aktiv në qasjen për:

- promovimin dhe mbrojtjen e diversitetit;
- mbrojtjen e politikave mjedisore;
- politikat e shëndetit.

Sidoqoftë, siç u vu re edhe me parë, kjo qasje nuk tregon se të anketuarit nga ana tjetër mendojnë se zhvillohen mjaftueshëm aktivitete në këto fusha ku të rinjtë janë më aktiv. Më pak se 30% mendonin se në vendbanimin e tyre zhvillohen mjaftueshëm aktivitete të cilat kanë në fokus promovimin e diversitetit (22.44%), politikave për mbrojtjen e shëndetit (2.49%) apo mbrojtjes së mjedisit (25.31%). Nga gjetjet në vijim vihet re gjithashtu se fushat rinia dhe diversiteti, rinia dhe eko-shëndeti shihen si fusha të rëndësishme veprimtarie për programin TEYC 2022 nga më pak se 7% e të anketuarve.

Ka një korrelacion pozitiv në lidhje me fushat që rinia shqiptare duhet të jetë më pjesëmarrëse, sipas të anketuarve, me fushat që ata i shohin si më të rëndësishme të veprimtarisë së programt TEYC 2022. Kështu pra, fushat që lidhen me mundësitë që rrisin kapacitetin e të rinjve dhe ekonominë kreative janë parë si ndër fushat më të rëndësishme të veprimtarisë së TEYC 2022, si dhe fushat ku të rinjtë duhet të jenë më pjesëmarrës.



7. Njohuri mbi titullin TEYC 2022

7.1 Titulli “Kryeqyteti Evropian i Rinisë”

Titulli “Kryeqyteti Evropian i Rinisë”, i njohur ndryshe si **European Youth Capital (EYC)** është një nismë që synon mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve të një qyteti evropian nëpërmjet krijimit të programeve dhe nisma afatgjata të qëndrueshme si dhe kthimin e qytetit në një qendër të takimeve ndërkombëtare dhe evropiane për çështjet e rinisë[21]. Nëpërmjet EYC, rinia angazhohet në mënyrë aktive, gjeneron ide të reja, kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, rriten fondet publike dhe mbështetja e donatorëve për aktivitete për rininë duke mundësuar ngritjen e çështjeve rinore në nivel Evropian[22].

58.17% e të anketuarve u shprehën se **kanë dëgjuar më parë për programin “Kryeqyteti Evropian i Rinisë”**, ndërsa 27.83% thanë jo. Ndërkohë 14% nuk ishin të sigurt nëse kishin dëgjuar më parë për programin EYC.



7.2 Titulli “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë” (TEYC 2022)

[21] European Youth Capital, Faqja zyrtare e aksesueshme këtu: https://www.youthforum.org/topics/youthcapital.
[22] KRK dhe BT, “Manual për menaxhimin e titullit “TIRANA EUROPEAN YOUTH CAPITAL 2022”, fq 3.

Për vitin 2022 titullin e fitoi Tirana, përmes aplikimit të bërë në vitin 2019 nga KRK në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë (BT). Shumica e të anketuarve (84.74%) deklaruan se **kanë dëgjuar pët titullin TEYC 2022**. Sidoqoftë shumica (48.47%) **nuk kishin shumë informacion rreth titullit**. Ndërsa 15.26% nuk kanë dëgjuar për titullin TEYC 2022.



Të anketuarit që e njohin titullin TEYC 2022, u shprehën se janë informuar kryesisht përmes:

- Mediave audiovizive (21.82%);
- Komunikimit nga të njohur (20.13%);
- Instagram (19.07%);
- Aktivitete promovuese (13.98%);
- Facebook (12.29%).

Më pak ishin informuar përmes web-faqes zyrtare të titullit, medias së shkruar apo përmes burimeve të tjera. Sidoqoftë, në momentin e shpërndarjes së këtij pyetësori faqja zyrtare e titullit sapo ishte krijuar, kështu që pritet që më tepër të informohen përmes faqes në të ardhmen. Një strategji e komunikimi për të komunikuar rreth programit TEYC 2022 është një hap shumë i rëndësishëm në arritjen e një audience më të gjerë. Në këtë aspekt duhen marrë parasysh rrjetet sociale më të përdorura dhe preferencat për të marrë informacion. Rjeti social më i përdorur nga të anketuarit është Instagram dhe më pak rrjetet e tjera sociale si Facebook, Tik Tok dhe Twitter. Përsa i përket mjetit të komunikimit më të preferuar për të marrë informacion, komunikimi përmes whats up është më i preferuar, duke u pasuar nga e-mail dhe pastaj Instagram.

Programi TEYC 2022 është ideuar mbi parimet e gjithëpërfshirjes së të rinjve në qytetin e Tiranës, nxitjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në procese vendimmarrëse dhe politike, krijimin e mundësive dhe rritjen e hapësirave ku të rinjtë të zhvillojnë aftësitë dhe idetë e tyre,

informimin e tyre për mundësitë e arsimimit, punësimit, argëtimit etj., por gjithashtu edhe përfshirjen e tyre në diskutime mbi çështje sfiduese kombëtare, rajonale dhe evropiane (të tilla si punësimi, ndryshimet klimatike, përfshirja e të rinjve më aftësi ndryshe etj)[23]. Programi ka 8 fusha veprimtarie direkte që kanë në fokus aspekte të ndryshme të mbështetjes së rinisë në Tiranë[24]:

1. Rinia zhvillon ekonomi kreative dhe inovacionin
2. Rinia dhe kultura
3. Rinia zhvillon kapacitetet
4. Rinia merr pjesë
5. Rinia dhe diversiteti
6. Rinia Evropiane
7. Rinia dhe Eko-shëndeti
8. Rinia dhe hapësirat publike

Të anketuarët patën hapsirë të tregojnë shkurtimisht çfarë dinë rreth programit të titullit TEYC 2022. Rreth 30% e të anketuarve ju përgjigjën kësaj pyetje. Disa nga të anketuarit që e njihnin tutullin u shprehën se e njihnin titullin shumë pak, por kishin dëshirë të bëheshin pjesë e kësaj nisme. Sidoqoftë një pjesë e madhe u shprehën se nuk e njohin mjaftueëshëm përveç se Tirana ka fituar titullin dhe do të zhvillohen disa aktivitete. Ata që e njihnin mirë treguan që dinin rreth titullit TEYC 2022 që nga momenti i aplikimit në nëntor të 2019-ës, kur Tirana u shpall TEYC 2022, duke triumfuar me 4 qytete të tjera finaliste si: Baia Mare (Rumani), Kazan (Rusi), Poznań (Poloni) dhe Varaždin (Kroaci). U shprehën gjithashtu se gjatë 2022 në Tiranë do të ketë qindra aktivitete të fushave të ndryshme për të rinjtë. Sipas tyre, programi me 8 tema të ndryshme inkurajon aktivizmin pozitiv duke i ndërthurur këto tema në projekte dhe aktivitete të ndryshme. Edhe 8 pikat e makro-programit u specifikuan. U vu re që kishin gjithashtu dijeni se ky makro program implementohet nga KRK në bashkëpunim me BT.

Të anketuarit u shprehën gjithashtu se kishin mësuar për këtë program nga:

- Takimet e organizuara nga përfaqësuesit e KRK në gjimanze apo universitete, etj;
- Daljet televizive të drejtuesve të TEYC 2022;
- Takimet e BT;
- Faqja zyrtare e TEYC 2022;
- Nga miqtë dhe të njohur.

Nga ana tjetër u vu re edhe një skepticizëm me gjithpërfshirjen e programit dhe përdorimin e tij për qëllime politike.

U vu re gjithashtu se njihnin edhe Thirrjen për Projekt Propozime që ishte hapur për organizatat e shoqërisë civile, për grupe informale dhe indvidë. Në pjesën më poshtë do të gjeni gjithashtu rezultatet e dhëna në ldhjje me pyetjen që ka pasuar rreth TPP.

[23] Po aty.
[24] Po aty.

7.3 Thirrja për Projekt-Propozime në kuadër të programit TEYC 2022

Në muajin Dhjetor 2021, KRK shpalli Thirrjen e Hapur për Projekt-Propozime (TPP) në kuadër të programit TEYC 2022. Kjo thirrje për projekt ide është në zbatim të drejtpërdrejtë të programit Activ∞ të parashikuar në TEYC2022 dhe synon mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, grupeve Jo Formale dhe Individ të cilët do të financohen për të zbatuar programet e parashikuara të TEYC 2022[25]. Ky program është ideuar në bazë të situatës aktuale të rinisë, nevojave dhe perspektivës së tyre, modeleve më të mira Evropiane për nxitjen e rinisë që të jenë pjesë aktive e jetës së qytetit, shprehjen dhe zbatimit e ideve të tyre për zhvillim etj[26]. Për programin Activ∞, KRK ka konsultuar grupe të shumta interesi si institucione qendrore dhe vendore, donatorë, organizata të shoqërisë civile, grupe jo-formale të cilat kanë në fokus rininë etj.[27]

58 % e të anketuarve u shprehën se **kanë dijeni në lidhje me TPP në kuadër të programit TEYC 2022**. Sidoqoftë 31.06% deklaruan se nuk kanë dijeni aspak dhe 21.5% kanë shumë pak dijeni në lidhje me TPP . Ndërsa 13.11% nuk ishin të sigurt për të dhënë një mendim.



Është e rëndësishme të merret parasysh se pothuajse gjysma e të anketuarve nuk e njohin titullin ose nuk kanë shumë informacion edhe kur e njohin, prandaj siç është elaboruar në seksionin në vijim, ka pritshmëri ndonjëherë jo-realiste. Sidoqoftë ata që e njohin titullin, e njohin në mënyrë korrekte, pasi nuk u vunë re përgjigje që nuk kishin lidhje me programin.

[25] TEYC 2022, Seksioni i Thirrjes për Projekt-Propozime. Faqja zyrtare e programit, e aksesueshme këtu: https://tiranaeyc2022.al/thirrje-per-projekt-ide-ne-kuader-te-tirana-european-youth-capital-2022/
[26] Po aty
[27] Po aty

8. Pritshmëritë nga zbatimi i programit TEYC 2022

8.1 Pritshmëritë nga programi TEYC 2022

Sipas rezultateve të anketës **pritshmëritë nga zbatimi i programit TEYC 2022 janë të larta**. Kështu, nga 73-83% e të anketuarve besojnë se zbatimi i programit TEYC 2022 do të:

- rrisë mundësitë e të rinjve për më tepër pjesëmarrje në komunitetin e tyre (81.87%);
- stimulojë të rinjtë për të qenë më proaktiv në çështje që ndikojnë tek ata (82.76%)
- ofrojë mundësi për rritje personale dhe profesionale të të rinjve (80.25%);
- stimulojë të rinjtë në njohjen e fuqisë së tyre si agjentë ndryshimi (78.10%);
- mbështesë sipërmarrjen tek të rinjtë (73.61%);
- nxisë përfshirjen e të rinjve në aktivitete sociale/ kulturore (82.41%)
- rrisë informimin e të rinjve mbi programe të BE-së (79.89%);
- nxisë përfshirjen e të rinjve nga grupet vulnerabël (73.25%);
- krijojë më shumë hapësira kreative për të rinjtë (78.28%);
- risë ndërgjegjësimin mbi politikat mjedisore tek të rinjtë (74.69%);
- nxisë nisma për mbrojtjen e shëndetit nga të rinjtë (74.33%);
- rrisë ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e edukimit joformal në zhvillimin personal (79.35%).



Shumica e të anketuarve beson gjithashtu se **zbatimi i TEYC 2022 do të krijojë mundësi punësimi për të rinjtë** (68.58%). Programi TEYC 2022, që me ngritjen e strukturës së zbatimit ka synuar punësimin e të rinjve indikator të cilin TEYC 2022 do ta monitorojë.

Ka një korrelacion pozitiv në lidhje me fushat që rinia shqiptare duhet të jetë më pjesëmarrëse, sipas të anketuarve, me fushat që ata i shohin si më të rëndësishme të veprimtarisë së programit TEYC 2022. Kështu pra, fushat që lidhen me mundësitë që rrisin kapacitetin e të rinjve dhe ekonominë kreative janë parë si ndër fushat më të rëndësishme të veprimtarisë së TEYC 2022, si dhe fushat ku të rinjtë duhet të jenë më pjesëmarrës.

Ndërkohë ka një korrelacion negativ përsa i përket disa pritshmërive të programit TEYC 2022, nëse i vendosim në një nivel krahasues variablat/qëndrimet e pritshmërive. Në një situatë të tillë pritshmëria se programi do të *krijojë mundësi punësimi për të rinjtë (68.58%)* dhe *do të 'mbështesë sipërmarrjen tek të rinjtë (73.61%)* janë ndër përqindjet më të ulëta krahasuar me fushat e tjera. Sidoqoftë, duhet theksuar se në vetvete këto pritshmëri janë ende të kënaqshme, pasi shumica shprehen pozitivisht, krahasuar me ata që mendojnë të kundërtën. Kështu pra, vetëm 20.83% nuk besojnë se programi do të mbështesë sipërmarrjen tek të rinjtë, krahasuar me 73.61% që e besojnë këtë gjë. Sidoqoftë, në lidhje me krijimin e mundësive të punësimit

për të rinjtë 25.31% janë skeptik krahasuar me 68.58% që besojnë se programi do të krijojë mundësi punësimi.

Nga ana tjetër, *Rinia merr pjesë* shihet si një nga fushat më të rëndësishme të veprimtarisë TEYC 2022. Në këtë rast edhe pritshmëria se programi *do të rrisë mundësitë e të rinjve për më tepër pjesëmarrje në komunitetin e tyre* (81.87%) është ndër më të lartat;

Informacion më i detajuar gjendet në Shtojcën 4.

Ndër **fushat më të rëndësishme të veprimtarisë së programit TEYC 2022** janë konsideruar:

1. **Rinia zhvillon ekonomi kreative dhe inovacion (22.44%)**
2. **Rinia zhvillon kapacitet (19.39%)**
3. **Rinia merr pjesë (14.36%)**
4. **Rinia Evropiane (13.82%)**
5. Rinia dhe kultura (11.31%)

Më pak se 7% kanë konsideruar të rëndësishme fushat e mëposhtme të veprimtarisë:

6. Rinia dhe hapësirat publike (6.64%)
7. Rinia dhe diversiteti (6.28%)
8. Rinia dhe Eko-shëndeti (5.75%)



Nuk duhet të harrojmë që fushat që lidhen me zhvillimin e ekonomisë kreative dhe rritjen e kapaciteteve u konsideruan edhe si fushat ku rinia shqiptare duhet të jetë më pjesëmarrëse.

45% e të anketuarve janë ndalur edhe te pyetja e hapur mbi pritshmëritë nga programi TEYC 2022. Nga analiza e përgjigjeve për këtë pyetje, vihet re se ka variacion të madh midis

pritshmërive të artikuluara: nga thjesht të marrit pjesë në aktivitetet e programit TEYC 2022 tek pritshmëri si 'rimëkembja ekonomike', ndryshime që shkojnë përtej impaktit që mund të ketë një program social i shoqërisë civile.

Gjithsesi, një pjesë e të anketuarve presin që programi të jetë gjithëpërfshirës me fokus kryesor rininë shqiptare duke i ofruar asaj risi për mundësi të ndryshme dhe ndryshime pozitive, sidomos për rritje kapacitetesh dhe për të qenë më aktivë. Nga programi pritet edhe rritja e mundësive të punësimit për të rinjtë. Të anketuarit u shprehën se presin edhe përfshirjen e të rinjve përtej Tiranës, diçka që programi synon ta arrijë edhe përmës TPP. Vihet re më vonë që këto pritshmëri vijnë dhe në formën e sygjerimeve për zbatimin e programit TEYC 2022.

Gjithashtu, ashtu sikurse vet synimi i programit, pritet që programi të transformojë qytetin në një pikë ndërkombëtare takimi si dhe të krijojë rrjetëzime dhe sinergji mes të rinjve nga e gjithë Evropa. Në këtë aspekt pritet shëndërrimi i 2022 në një vit ku të rinjtë nga Europa mund të zbulojnë Tiranën dhe pse jo më tej Shqipërinë.

Të anketuarit besojnë se programi TEYC 2022 do të nxisë nisma për mbrojtjen e shëndetit, promovimin e kultures, diversitetit, për një Shqipëri të gjelbër dhe kultivimin e një kulture mjedisore të pastër.

Përveç rritjes së nivelit të vet-besimit te të rinjtë, programi shihet gjithashtu edhe si një arsye për të mos u larguar nga vendi. Të anketuarit dëshirojnë që programi të nxisë dëshirën për të jetuar në Shqipëri.

Me raste shihet edhe një shenjë skepticizmi ndaj përfshirjes së Bashkisë në këtë nismë.

8.2 Sygjerime për zbatimin e programit TEYC 2022

Rreth 40% e të anketuarve dhanë sygjerimet e tyre për zbatimin e programit TEYC 2022. Ndër sygjerimet për tu marrë në konsideratë gjatë zbatimit të programit TEYC 2022" sipas të anketuarve janë sipas drejtimeve të mëposhtme:

- ***Parimet: Gjithëpërfshirje, transparencë, promovim/informim dhe cilësi***

- Sygjerimi që programi të jetë sa më gjithëpërfshirës ishte ndër sugjerimet më të përmendura kryesisht në dy drejtime:
    - 1) Përmendet përfshirja e pjesëmarrësve të rinj, jo vetëm ata që angazhohen përherë në OJF, të mos angazhohen vetëm ata që angazhohen gjithmonë dhe që përfaqësojnë të tjerët.
    - 2) Të shtrihet përtej Tiranës, sidomos t'i kushtohet vëmendje edhe qyteteve apo zonave më të vogla urbane, ku rinia shqiptare ka më shume nevojë për

veprimtari, sidomos në ato zona që janë më të distancuara dhe mundësitë për të rinjtë janë të kufizuara dhe të pamjaftueshme.
    - Ti jepet vëmendje nismave individuale dhe grupeve Jo Formale dhe si e tillë t'ju jepet prioritet nga TPP.
    - Një thirrje publike për të rinjtë që punojnë e veprojnë jashtë dhe që spikasin në profesionet e tyre.
    - Të merret parasysh dhe shkëmbimi kulturor në mënyrë që të rinjtë të provojnë eksperienca të reja, të mesojnë kultura të reja duke qene pjesë e atyre kulturave.
- Të sigurohet sa më shumë transparencë. Edhe nga të anketuarit sygjerohet menaxhimi i buxhetit nga KRK si institucion i pavarur dhe jo nga bashkia.
- Sygjerohet promovimi i programit TEYC 2022 dhe aktiviteteve të tij sa më shumë. Sidomos kërkohet që informacioni të ketë sa më shumë burime përhapjeje. Në këtë drejtim sygjerohen sa më shumë njoftime, në rrjete të ndryshme sociale, media audiovizive, e shkruar etj, për të prekur një numër të madh pjesëmarrësish, apo për të qenë në dijeni. Në këtë aspekt sygjerohej edhe informim përmes një targetimi të drejtpërdrejtë në qendrat e edukimit, gjimnaze dhe universitete.
- Informim i të rinjve.
- Të synohet cilësi dhe jo sasi aktivitetesh.
- Analiza e problematikave me të dhena statistikore dhe studimore për situaten aktuale të 8 programeve që të ofrojë të dhëna për t'ju referuar gjatë zbatimit të projekt ideve nga të rinjtë.

- ***Qasja ndaj llojit dhe tematikës së aktiviteteve:***

- Aktivitetet të kenë karakter përmbajtësor, informues dhe të jenë të vlefshme si për rritjen e kapaciteteve të të rinjëve dhe angazhimin e tyre në fushën që janë të interesuar.
- T'i kushtohet rëndësi trajtimit të temave si seksizmi, racizmi dhe diskriminimi ndaj personave LGBTQAI+, pabarazia gjinore dhe nepotizimi.
- Vëmendje për sportin/sportistët dhe lojrat sportive midis gjimanazeve.
- Konkurse talentesh.
- Kampe dhe aktivitete që zhvillojnë aftësitë e lidershipit.
- Të zhvillohen aktivitete që synojnë promovimin e qyteteve si psh *Dita e Qytetit X*.
- Të organizohen ditët e rinisë në bazë qarku.
- Promovimi i mundësive të reja punë për të rinjtë e sapodiplomuar.
- Programe këshillimi për zgjedhjen e karrierës dhe hapsirat e punësimit për 16+
- Kujdesi për kafshët dhe strehimi i tyre.
- Të ketë programe argëtuese si festa përveç edukuese.
- Të promovohet mbrojtja e institucioneve kukturore.
- Përfshirja e të rinjve në çështje sociale përmes protestave paqësore për të drejtat e tyre dhe shërbime të ndryshme si ato shëndetësore apo arsimore, si dhe për çështjen e papunësisë.

- ***Target grupet***

- Të krijojë sa më shumë hapësira kulturore, sidomos për grupet vulnerabël.
- Vëmendje e veçantë për komunitetin egjiptian.
- Të gjitha shkollat e kryeqytetit të përfshihen intesivisht në këtë program. Programi të përcillet në Ministrinë e Arsimit që të bëhet një ndërhyrje konstruktive tek Kurrikula, Programet lëndore me qëllim që orari i mësimit të mos bëhet vetëm brenda klasës, por që edhe të shfrytëzohen ambjentet e jashtme për procesin mësimor.
- Të bashkëpunohet jo vetëm më OJF shqiptare por edhe me të tjera nga vende të ndryshme të Evropës.

- ***Ambjent mundësues për pjesëmarrje***

- Përfshirja e të rinjve në vendimmarje.
- Rritja e ndërgjegjes për të njohur veten dhe tjetrin në nivel emocional.
- Qasje sa më kreative dhe interesante që ti bëjë të rinjtë të ndjehen komod gjatë angazhimit të tyre.
- Aktivzimi i të rinjve në mënyrë vullnetare por edhe njohja e kësaj eksperience përmes një dëshmie vullnetarzimi/certifikate.
- Lehtësim procedurash.
- Një qasje sa më praktike dhe jo teorike dhe e vështirë për tu kuptuar.

Ajo që vlen të theksohet në reagimin ndaj këtij pyetësori është se pothuajse 45% e të anketuarve **u shprehën se dëshirojnë të përfshihen në aktivitetet e organizuara në kuadër të programit TEYC 2022** duke lënë një adresë emaili apo numër celulari. Që në momentin e përpunimit të të dhënave, lista e kontakteve i ka kaluar stafit të TEYC 2022 me prioritet që të angazhojë të interesuarit në aktivitetet e organizuara në kuadër te programit TEYC 2022, duke filluar që nga angazhimi si aktivistë në ceremoninë e hapjes së eventit, mbajtur më 4 Shkurt 2022, te Pallati i Kongreseve. Rekomandimi për KRK është të bëjë një plan për angazhimin e të interesuarve dhe ta prioritarizojë përfshirjen e tyre aktive.

9. Konkluzione dhe rekomandime

Duke qenë se rrjeti social më i përdorur nga të anketuarit është Instagram dhe mjeti më i preferuar i komunikimit për të marrë informacion është ëhats up, TEYC 2022 duhet të konsiderojë shpërndarjen e informacionit në lidhje me aktivitetet e programit edhe përmes këtyre mjeteve të komunikimit, por sigurisht nuk duhet neglizhuar forma zyrtare e komunikimit përmes email. Gjithashtu, duhet pasur parasysh impakti që ka komunikimi përmes mediave audiovizive, pasi rezultoi si një ndër burimet kryesore nga i ciki të anketuarit janë informuar në lidhje me TEYC 2022 (21.82%).

Tre çështjet kryesore që konsiderohen si **probleme kyç** me të cilat po përballet Shqipëria janë: **situata ekonomike** (46.86%), **papunësia rinore** (42.37%) dhe **ikja e trurit** (40.93%). Në këtë aspekt rekomandohet:

1. Prezantim i këtyre gjetjeve dhe përdorimi i tyre për **të sjellë në qëndër të vëmendjes situatën e të rinjve,** sidomos përmes edhe inciativave advokuese.
2. **Analizë e mëtejshme e këtyre problemeve** edhe përmes programit TEYC 2022 **duke përfshirë të rinjtë në mënyrë domethënëse**. Kjo mund të bëhet përmes aktiviteteve dhe grupe pune me të rinjtë (workshope) dhe përgatitja e **policy papers** si dhe mundësi që rekomandimet e të rinjve të prezantohen përpara politikbëresve.
3. **Gjetjet** e kësaj analize **të merren parasysh dhe të përdoren për të analizuar dhe studiuar më tepër të treja çështjet**, me qëllim **identifikimin e arsyeve të kësaj qasje**. P.sh në rastin e fenomenit të ikjes së trurit të merret parasysh që 75.76% shprehen se të rinjtë dëshirojnë të largohen nga Shqipëria, si dhe 35.73% nuk e shohin të ardhmen në Shqipëri. Po ashtu, pothuajse gjysma e të anketuarve deklarojnë se nuk janë dakord që të rinjtë bëjnë një jëtë të kënaqshme në Shqipëri.

Rekomandohet **përdorimi i qasjes së edukimit jo-formal** në aktivitetet e zbatuara në kuadër të programit TEYC 2022, sidomos në aktivitetet e projektzbatuesve. Sygjerohen sa më shumë aktivitete jashtë-shkollore për institucionet e edukimit që aplikonë metodologjinë e edukimit joformal. Gjithashtu, rekomandohet për institucionet e tjera të mbështesin sa më tëpër iniciativa që vënë fokusin te edukmin jo-formal, duke marrë parasysh edhe që 64.09% e shohin edukimin jo-formal si të rëndësishëm **në zhvillimin personal**. Sidoqoftë, duhet pasur kujdes dhe te theksohet se promovimi dhe mbështetja e edukimit jo-formal, nuk nënkupton kurrsesi se edukimi formal nuk është i rëndësishëm. Përkundrazi një kombinim i të dyja qasjeve do të ishte i frytshëm.

